



KOSICT



Dean Frederick Terman and his



#KosICT17

27-28 TETOR, 2017

Organizuar nga:



STIKK

Në bashkëpunim me:



UNIVERSUM
COLLEGE

27

Çfarë është

KosICT filloi si konferencë rajonale e cila për synim kishte parashtrimin e temave globale të TI në Ballkan, duke sjellur përvojën dhe njohuritë e ekspertëve ndërkombëtarë, rajonal e vendorë, e në të njëjtën kohë duke promovuar sektorin e TIK në Kosovë.

KosICT?

Panelet e diskutimit ishin mundësi e mirë për të fituar vëmendjen e publikut dhe për të krijuar bashkëpunim në mes të dy palëve: prezantuesve dhe pjesëmarrësve. Prezantuesit ndanë me ne perspektivën e tyre të gjerë rreth fushave të e tyre të interesit duke mbajtur debate, diskutime, e duke komunikuar me të pranishmit.



Më 27 dhe 28 tetor 2017, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), në partneritet me Qendrën e Inovacionit në Kosovë (ICK) dhe kolegjin Universum, organizuan edicionin e gjashtë të KosICT, që u mbajt në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Temat që u diskutuan në këtë edicion ishin: Blockchain, AR, SaaS, FinTech, IoT, VR, AI, E-Commerce, Security Wearables, Autonomous Cars, Cloud Computing, Digital Marketing, Bitcoin, etj.

Vendi u nda në dy salla. Në njërin sallë, të quajtur “salla e kuqe”, u mbajtën të gjitha fjalimet dhe panelet e diskutimit, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjonin tema të cilat ishin relevante për fushat e tyre. Në sallën tjetër të quajtur “këndi i inovacionit” morën pjesë startup të ndryshëm të cilët u bashkuan me qëllim që të tregonin rreth projekteve të tyre.

Gjatë dy ditëve të KosICT 2017, morën pjesë 26 prezantues nga kompani të mirënjohura kombëtare dhe ndërkombëtare si: IPKO, Electronic Arts (EA), World Summit AI, Inbot, Gjirafa, Musala Soft, Adaptivit, Cactus, Cryptelo, ULedger dhe Trekandi. Përveç tjerash, gjatë këtyre dy ditëve të konferencës, në kuadër të KosICT 2017 u ofrua një kënd i veçantë, ekskluziv për biznese.

KosICT17 jo vetëm që i'u dha mundësi pjesëmarrësve të njihen me mundësi të të bërit biznes, por gjithashtu edhe të degjojnë histori nga figura prominente në botën e ndërmarrësisë. Të pranishmit shijuan tregimet e kompanive kosovare dhe ndërkombëtare të teknologjisë, e në anën tjetër përfituan nga lidhjet që mund të krijonin me ndërmarrës, investitorë, udhëheqës të korporatave dhe inovatorë.

Në konferencë ishin të pranishëm rreth 2000 pjesëmarrës.

Agjenda

(dita e parë, 27.10.2017)

Salla e Kuqe

6

9:00-10:00	Regjistrim
10:00-10:15	Fjalimet hyrëse: Bardh Kadiu , Drejtor i Konferencës KosICT, Mentor Sahiti , Kryetar i Bordit Ekzekutiv, STIKK, dhe Valdrin Lluka , Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Republika e Kosovës
10:15-10:45	Prezantim hyrës: “5G: the future of Mobile” Robert Erzin , IPKO Telecommunication
10:45-11:30	Panel diskutimi rreth “The future of Mobile Data” me: Robert Erzin , IPKO Telecommunication, dhe Driton Hapçiu , CACTUS <i>Moderuar nga Alban Kastrati</i>
11:30-12:00	“From Knowledge Economy to People Economy” nga: Delyan Lilov , Musala Soft
12:00-13:00	Pauzë e ndarë për rrjetëzim
13:00-13:30	“Business agility with Cloud Technologies” nga: Mladen Baranek , Miadria Group, dhe Lovre Gabrilo , Miadria Group
13:30-14:15	Panel diskutimi rreth “The future of Commerce” me: Agron Gashi , Raiffeisen Bank Kosovo, Mergim Cahani , Gjirafa Inc., dhe Yllka Metaj , AZTECH electronics <i>Moderuar nga Denis Gafurri, SMARD</i>
14:15-14:45	“FinTech and the possibilities it offers” nga: Kreshnik Halilaj , Raiffeisen Bank Kosovo
14:45-15:45	Panel diskutimi rreth “FinTech and its Application” me: Kreshnik Halilaj , Raiffeisen Bank Kosovo, Jetmir Halimi , Trekandi, dhe Diana Nokaj , Kosovoldeas <i>Moderuar nga Peter Hopwood, Hopwood Communications</i>
14:45-16:00	Pauzë e ndarë për rrjetëzim
16:00-16:45	Fjalim përmbylës “The Silicon Valley Century and Beyond...” nga Jeff Burton , Electronic Arts

7

(dita e dytë, 28.10.2017)

Salla e Kuqe

9:30-10:00	Regjistrimi
10:00-10:30	Fjalim hyrës: “Artificial Intelligence and Humans” Mike Reiner , World Summit AI
10:30-11:00	“The Rise of Emotionally Intelligent AI” nga: Mikko Alasaarela , Inbot
11:00-11:45	Panel diskutimi rreth “Artificial Intelligence” me: Mike Reiner , World Summit AI, dhe Mikko Alasaarela , Inbot <i>Moderuar nga Peter Hopwood, Hopwood Communications</i>
11:45-12:30	Panel diskutimi rreth “Software as a Service” me: Erion Nako , Sinteza Co, Valon Sopi , GoodWerp, dhe Zana Tabaku , APPDEC <i>Moderuar nga Mentor Sahiti, Bordi Ekzekutiv, STIKK</i>
12:30-13:45	Pauzë e ndarë për rrjetëzim
13:45-14:00	“Stand & Deliver: Improve your Communication Skills” nga: Peter Hopwood , Hopwood Communications
14:00-14:45	“How Blockchain is going to revolutionise the world” nga: Martin Baroš , Cryptelo
14:45-15:45	“Discussion panel on “The future of Blockchain” me: Peter Gelardi Mikkelsen , Blockchain Technologies Corporation, Martin Baroš , Cryptelo, Mikko Alasaarela , Inbot, dhe Taulant Ramabaja , ULedger <i>Moderuar nga Ejup Qerimi, BIT Consulting Group</i>
15:45-16:30	Fjalim përmbylës nga Peter Gelardi Mikkelsen , Blockchain Technologies Corporation

KosICT Nights

(Mbremja e parë, 27.10.2017)

18:30	FuckUp Night, KosICT version More: https://www.facebook.com/events/1506483302774988/
21:00	KosICT17 After-Party More: https://www.facebook.com/events/523884297960384/

(Mbremja e dytë, 28.10.2017)

21:00	Speakers & Partners Dinners (vetëm për mysafirë të ftuar) @ Gagi Restaurant, Fehmi Agani 1, 10000 Prishtinë
-------	---

Fjalimet Hyrëse

8

KosICT 2017 zyrtarisht u hap nga drejtori i konferencës z. Bardh Kadiu, i cili mirëpriti të gjithë të pranishmit duke theksuar dedikimin e kompanive të TI në Kosovë. Në fjalimin hapës të konferencës z. Kadiu ndau edhe vizionin dhe qëllimin e konferencës për të ardhmen.



Pas fjalimit të z. Kadiu, fjalën e mori Drejtori i Bordit të STIKK z. Mentor Sahiti. Ai theksoi se si KosICT është krijuar për të ngritur dhe motivuar biznese duke dëgjuar storie të suksesit nga folës me eksperiencë, duke shfrytëzuar këndin e inovacionit, sallën e biznesit dhe eventet e rrjetëzimit gjatë mbrëmjes.



Patëm nderin që kishim të pranishëm edhe Ministrin e Zhvillimit Ekonomik z. Vladrin Lluka i cili në fjalimin e tij hyrës tregoi rreth planeve të ministrisë që ai perfaqëson për vazhdimin e përkrahjes së kësaj konference dhe theksoi potencialet që shteti ynë ka për të hyrë në tregun global.



9

Dita 1

Salla e Kuqe

Konferenca nisi në hapësirën e sallës së kuqe ku të gjithë pjesëmarrësit patën rastin t'i dëgjojnë fjalimet e hapëse. Ndër fjalimet hapëse kryesore ishte i shefit ekzekutiv të IPKO-s, Robert Erzin. Ai foli mbi rrjetin 5G, të ardhmen e shërbimeve telefonike, si dhe mbi ndikimin e kësaj teknologjie në të ardhmen e afërt.



Moderator i konferencës në sallën e kuqe ishte Peter Hoopwood, i cili mbajti zgjuar gjithë audiencën me energjinë dhe entuziazmin e dhënë përgjatë gjithë kohës. Përpos kësaj, z. Hoopwood u tregua bujar me audiencën duke i prezantuar truket e tij rreth të folurit në publik dhe komunikimit në përgjithësi.



Pas këtij fjalimi, u mbajt paneli i diskutimit mbi të ardhmen e të dhënave mobile i cili u moderua nga Alban Kastrati, ekspert i marrëdhënieve publike. Ky panel ishte i përbërë nga Driton Hapçiu, shef ekzekutiv i kompanisë Cactus dhe Robert Erzin, shef ekzekutiv i IPKO-s. Mes tjerash, në fjalimet e tyre ata përmendën rritjen e të dhënave mobile në Kosovë, si dhe mënyrën se si kjo teknologji do të ndikojë në fushën e telekomunikimit. Të dy panelistët shpërfaqën perspektivat personale, si dhe rrugën drejt suksesit në këtë çështje.



Pas panelit të diskutimit rreth të ardhmes së të dhënave mobile, **Delyan Liloc** (Musala Soft) mbajti fjalimin me titull **"Nga Ekonomia e Dijes në Ekonominë e Njerëzve"**.


Z. Liloc ndau me audiencën përvojën e tij sa i përket themelimit të Musala Soft, si dhe vështirësitë që i kaloi gjatë këtij procesi. Si grup dikur i inspiruar nga dëshira për të gërshetuar teknologjinë dhe inovacionin drejt realizimit të ideve të mëdha, vazhdojnë drejt synimit po të njëjtë edhe sot.

Gjithashtu, z. Liloc foli mbi mënyrën se si kompanitë po e ndërrojnë perceptimin ndaj investimit në burimet njerëzore, që do të thotë se investimi sot po jepet për trurin, e jo për duart si në të kaluarën.



Fjalimet vazhduan me **Mladen Baranek** dhe **Lovre Gabrilo**, nga Miadria Group, të cilët trajtuan temën **"Shkathtësitë biznesore me teknologjinë cloud"**.

Struktura e llogaritjeve cloud u mundëson bizneseve përparësi të caktuara të cilat nuk mund t'i gjejnë përmes opsioneve tjera teknologjike. Bizneset e vogla shpesh kërkojnë mënyra që të arrijnë teknologjinë e bizneseve të mëdha dhe këtë u'a mundësojnë zgjidhjet e bazuara në cloud. Fleksibiliteti dhe përshtatja e aftësive të cilat i jep ky system i bazuar në cloud mund të rrisë gatishmërinë dhe sigurinë e në anën tjetër të zvogëloj kostot. Më poshtë mund të gjeni veçoritë e sistemit cloud që i mundësojnë biznesit të jetë sa më i shkathët.



Pas fjalimit nga përfaqësuesit e Maidra Group, erdhi koha për bizneset e tregtisë elektronike (e-commerce), me pjesëtarët në panelin e diskutimit: **Agron Gashi** (Raiffesen Bank Kosovo), **Mergim Cahani** (Gjirafa) dhe **Yllka Metaj** (AZTECH electronics). Ky panel është moderuar nga **Denis Gafurri** (Smard).

Panelistët ndanë me audiencën vështirësitë që patën në rritjen e kompanive të tyre, dhe si inkurajuan kosovarët drejt blerjes së produkteve online. Ata thanë se si shtet, Kosova qëndron larg pranimi të tregtisë online në shoqëri, mirëpo fundja kjo gjë varet edhe nga ajo se çfarë saktësisht konsiderojmë kur themi "larg". Mergim Cahani tha se nëse e krahasojmë shoqërinë tonë me shtetet e tjera të zhvilluara, atëherë po, jemi larg. Mirëpo, nëse e krahasojmë vetëm brenda kushteve aktuale të shtetit, atëherë jemi duke bërë hapa të vegjël, por njëkohësisht efektiv. Të gjithë panelistët u pajtuan me mendimin se tregtia elektronike është e ardhmja e shitjes dhe blerjes online, duke marrë parasysh se ofrohen shumë mundësi me globalizimin e sotëm.



“FinTech dhe mundësitë që i ofron” ishte fjalimi i radhës i mbajtur nga **Kreshnik Halilaj** (Raiffeisen Bank Kosovo)

Fintech është një platformë e teknologjisë financiare, që paraqet një sektor në zhvillim të shërbimeve financiare të shekullit 21. Fillimisht, ky term kishte gjetur përdorim për teknologjinë e aplikuar për konsumatorët aktual të institucioneve tregtare financiare. Që nga fundi i dekadës së parë të shekullit 21, ky term është zgjeruar për të paraqitur çdo lloj inovacioni teknologjik në sektorin e financave, duke përfshirë inovacionet në arsimimin për financa, banka komerciale, investime, si dhe kriptomonedhat si Bitcoin.



Pas prezantimit të FinTech nga z. **Halilaj**, u mbajt një tjetër panel diskutimi me temën **“FinTech dhe aplikimi i tij”**. Paneli përbëhej nga **Kreshnik Halilaj** (Raiffeisen Bank Kosovo), **Jetmir Halimi** (Trekendi) dhe **Diana Nokaj** (Kosovaldeas).

“FinTech është e ardhmja e shërbimeve financiare”. Teknologjia financiare në përgjithësi definohet si çdo lloj inovacioni teknologjik në shërbimet financiare. Të angazhuarit në këtë industri zhvillojnë teknologji të reja për përçarjen e tregjeve tradicionale financiare. Paneli diskutoi rëndësinë e zhvillimit të kësaj teknologjie në Kosovë, si dhe vështirësitë që mund të hasim gjatë procesit të zbatimit. FinTech ka aplikim të gjerë dhe gjen vend për përdorim të kriptomonedhave dhe në teknologjinë blockchain.



Fjalimi përmbyllës u mbajt nga Jeff Burton (Electronic Arts), me temën **“Shekulli i Silicon Valley dhe përtej tij”**.

Bashkë-themeluesi i Electronic Arts i'a doli ta linte audiencën me mbresa duke diskutuar se si Silicon Valley arriti nivelin që posedon sot, si dhe se çfarë pritet përtej këtij niveli. Z. Burton ndau historinë e tij që nga fillimi i karrierës deri më sot, nga interesimi i tij në lojëra dhe në krijimin e sporteve EA e deri tek fokusi i tij aktual në lojërat e realitetit virtual (VR). Kjo industri po rritet çdo ditë e më tepër dhe z. Burton beson se teknologjia VR po hapë një perspektivë të re për industrinë e lojërave.



Dita e dytë e KosICT-së vazhdoi duke mirëpritur entuziastë të teknologjisë nga e gjithë bota, me një agjendë të ngarkuar me aktivitete të ndryshme, të cilat quan në lidhje biznesore si dhe në bashkëpunime dhe investime të ardhshme.

Në anën tjetër, dita e dytë në sallën e kuqe filloi me temën lidhur me **“Intelegjenca Artificiale dhe Njerëzimi”**, nga **Mike Reiner** (World Summit AI).

Ai foli për më të rejat rreth inteligjencës artificiale dhe çfarë pritet në të ardhmën nga kjo fushë. Me fjalimin e tij rreth inteligjencës artificiale në bashkëveprim me njerëzit, ai shëndërroi bisedën në një nivel tjetër. Ai theksoi se fuqia e vërtetë e inteligjencës artificiale gjindet brenda informatave kontekstuale.



Pas prezantimit të z. Reiner, konferenca vazhdoi me temën mbi inteligjencën artificiale. Në prezantimin e radhës që për temë kishte **“Ngritja emocionale e Inteligjencës Artificiale”**. **Mikko Alasaarela** (Inbot) shpjegoi për mundësinë që IA mund të kalojë kapacitetin njerëzor për të kuptuar, kontrolluar dhe shprehur emocionet. Gjithashtu ai ndau me publikun idenë dhe vizionin e kompanisë së tij-Inbot e cila merret me CRM dhe robotë të marketingut të cilët na sulmojnë me biliona spams, reklama të programuara, email-a dhe postime në rrjetet sociale çdo ditë.



Pasi përfunduan të dy prezantimet nga z. Reiner dhe z. Alaasarela, radhën e kishte një bisedë në mes të dy prezantuesve në lidhje me temat që ata prezantuan paraprakisht. Ata folën për **“Intelegjencën Artificiale”** dhe zhvillimin e ndikimin që do të ketë në të ardhmen. Për mendimin e tyre, inteligjenca artificiale është e ardhmja e njerëzimit. Publiku poashtu ishte përfshirë në debat duke shtruar pyetje dhe duke ndarë mendimet e tyre rreth kësaj çështjeje.



Pas kësaj, u mbajt një panel diskutimi me temën **“Software si Shërbim”** i moderuar nga presidenti i bordit të STIKK, **Mentor Sahiti**. Në panel morën pjesë: **Erion Nako** (Senteza CO), **Valon Sopi** (Goodwerp INC) dhe **Zana Tabaku** (APPDEC). Ata ndanë me publikun mendimin e tyre rreth kësaj teknologjie dhe diskutuan se si mund të integrohet kjo teknologji në shtetin tonë si shërbim. Gjatë kohës që panlistët ndanë mendimet e tyre publiku tregoi interesim të madh.




Pas përfundimit të panelit, ishte radha për pushimin e drekës, për tu kthyer në sallë me z. **Peter Hopwood** (Hopwood Communications) i cili prezantoi rreth temës së quajtur **“Qëndro dhe Shpërndaj: Përmirësoni aftësitë e Komunikimit”**.

Ai prezantoi te publiku teknika të gjuhës së trupit dhe foli rreth rëndësisë së sjelljeve të njeriut për rritje të besueshmërisë dhe ndikimit, si dhe tregoi si t'i drejtohem me më shumë besim një audience. Gjithashtu dha këshilla se si të flasim drejtë e qartë kur prezantojmë idetë tona, në mënyrë që të funksionojnë. Ai tregoi një metodë se si t'i sjellim më shumë vlerë këtyre ideve dhe si të rrisim mundësinë e suksesit.



Në vijim u diskutua rreth temës shumë aktuale në botë këto ditë – blockchain **Martin Baroš** (Cryptelo) prezantoi temën **“Si Blockchain do të ndihmoj zhvillimin në gjithë botën”**. Z. Baroš ndau me publikun eksperiencën e tij në Cryptelo dhe mendimin e tij mbi blockchain dhe të ardhmën e kësaj teknologjie. Besohet se kriptomonedhat janë e ardhmja, dhe shumë shpejt paratë do të zëvendësohen me to, ashtu që njerëzit duhet të fillojnë sa më shpejt të investojnë në këtë teknologji. Z. Baroš beson se kriptomonedhat dhe blockchain teknologjia do të ndryshojnë jetën e njerëzimit për të mirë dhe do të sjellë një etapë të re në botë.




Pas përfundimit të prezantimit të z. Baroš mbi blockchain, u vazhdua me një panel diskutimi me temën **“E ardhmja e Blockchain”**. Në panel morën pjesë **Peter Gerald** (Blockchain Technologies Corporation), **Martin Baroš** (Cryptelo), **Miko Alasaarela** (Inbot) dhe **Taulant Ramabaja** (ULedger). Ky panel është moderuar nga **Ejup Qerimi** (BIT Consulting Group).

Panelistët treguan mendimet e tyre mbi blockchain dhe të ardhmën e saj. Temat e diskutimit në mes të panelistëve bënë që publiku të informohet më tepër rreth kësaj teknologjie. Poashtu panelistët treguan eksperiencat e tyre personale në lidhje me teknologjinë Blockchain dhe ndikimin që do të ketë në botë.



Si ekspert i fushës së Blockchain, z. Mikkelsen ndau me publikun mënyrën e funksionimit dhe domethënien e kësaj teknologjie. Këshilla e z. Mikkelsen ishte mos të humbim kohë dhe të fillojmë investimet në këtë teknologji sepse shumë shpejt do ta zëvendësoj paranë.



Këndi i Inovacionit

Përveç prezantimeve në sallën e kuqe, Këndi i Inovacionit ishte edhe një ngjarje për tu theksuar në konferencën KosICT'17. Gjatë dy ditëve të konferencës, perfaqësuesit e startup-ëve arritën të tregojnë dedikim dhe pasion në ndërmarrësi. Këta ndërmarrës të rinj gjatë gjithë kohës prezantuan idetë e tyre tek investitorët, folësit dhe tek publiku i gjerë.



Përveç që mësuan nga prezantimet në sallën e kuqe, ata gjithashtu patën mundësinë që të përfshiheshin dhe të ndanin perspektivat e tyre rreth trendeve të teknologjisë.

Ambasadori Gjerman, z. **Christian Heldt** dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik z. **Valdrin Lluka** vizituan këndin e inovacionit ku ata biseduan me startup mbi vizionin dhe qëllimet e tyre. Ata u mahnitën me të arriturat e ndërmarrësve të rinj dhe arritjet e tyre, duke pasur parasysh se çfarë kushte të pakta ofron shteti i Kosovës për ndërmarrësi. Këndi i Inovacionit pati gjithsej 16 startup dhe hyrja ishte falas për të gjithë ata që treguan interesim në lidhje me inovacionin. Disa nga startup-ët mbajtën prezantime, ku treguan qëllimet e ideve të tyre.

Startup-ët që morën pjesë në Këndin e Inovacionit ishin:

Formon është një startup i cili bashkon dizajnin dhe teknologjinë duke krijuar manualisht 3D printerin. Ekipi beson që ky lloj i teknologjisë në një të ardhme të afërt do të ketë rëndësi të madhe në ndërmarrjet ndërtimore, ashtu sikur kompjuterët që kanë rëndësi në krijimin e dizajneve të ndryshme.

Solaborate/Hello është një platformë e komunikimit. Për qëllim kanë ri-shpikjen e mjeteve të komunikimit dhe shërbimeve të cilat ofrojnë mundësi për përmisimin e jetërave të njerzve duke zvogëluar përdorimin e karbonit. Kjo kompani po mundohet që ti bëjë bashkë të gjitha nevojat e komunikimit, në mënyrë që të komunikojmë me këdo që duam në mënyrë më produktive dhe të kënaqemi së bashku.

LabBox është një produkt teknologjik edukativ sipas të cilit përvoja me Labbox u mundëson studentëve të përjetojnë mësimin praktik edhe jashtë klasëve të tyre. Libri unik i ilustruar i cili është i perfshirë në Labbox do të krijonte aventurën e cila i nevojitet çdo fëmijë për të eksploruar botën e teknologjisë, inxhinierisë, shkencës dhe të mesojnë aftësi të nevojshme për shekullin e 21-të.

Neo - Enum është një startup zhvillues i software/hardware-it. Enum beson se duhet të kujdesemi për gjërat të cilat i duam, andaj po zhvillojnë një kollare të mençur NEO për kafshët shtëpiake e cila do të j'u ndihmoj pronarëve të dijnë vendndodhjen e tyre dhe gjendjen shëndetësore të kafshëve.

Krrato ka për qëllim të zvogëloj shpenzimet e punës me printer 3D dhe të ruajnë ambientin duke recikluar plastike. Pasi që printimi 3D është duke u shperndarë shumë shpejt dhe sasia e hedhurinave të plastikës po rritet çdo dite, zgjidhja është një makinë desktop nxjerrëse e plastikës e cila do të mbrojë ambientin dhe të përmisojë jetën e njerzve edhe në aspektin ekonomik.

arcK/Animus është një ekip i përbërë nga inxhinierë, shitës strategjik dhe ndërmarrës. Projekti kryesor i tyre është Animus Home, i cili është një sistem i mençur për të kontrolluar pajisjet në shtëpi dhe për t'i automatizuar funksionet e tyre në rutinë; Cilësohet si zemra e shtëpisë e mbledhur në një vend.

Bitsaphire bënë konsulencë për teknologjinë blockchain në kompani dhe startup-e. Është themeluar 4 vite më parë dhe konsiderohet si njëra nga konsulencat e teknologjisë blockchain më të vjetra në vend. Fokus kryesor ka konsulencën edukative për korporata dhe startup-e rreth zhvillimit të kriptografise dhe blockchain teknologjisë.



Modicular bënë prototipe dhe dizajne për orendi të mençura, me theks të posaçëm për persona me nevoja të veçanta.

Zombie Soup janë të specializuar në inteligjencën artificiale ose realitetin virtual. Konsiderohet si përzierje e ideve të cilat duan të realizohen, por për të cilat nevojitet kohë, bashkëpunim, rritje dhe ekip i zhdërvjellët. Qëllimi i tyre si përfundim, është që të kemi një eksperiencë sa më reale sa i perket botës virtuale.

SyncLab krijon produkte për marketing duke përdorur animacione 3D me platformat si - Google Cardboard. Poashtu bënë edhe virtualizimin e projekteve arkitekturale. Ata mundësojnë promovimin e AR dhe VR me anë të teknologjisë më të fundit.

Platforma Akademia është një kompani EdTech e cila ka për vizion të mbrojë integritetin akademik, poashtu edhe ta ngritë kualitetin akademik duke ofruar shërbime falas për materiale akademike dhe detektorë për plagjiaturë.

Zag Apps krijon aplikacione telefonike me dizajne dhe dukje sa më të thjeshtë. Efienca, ekspertiza dhe teknologjia më e re do të na mundësonte të mbanim dokumentet tona në platforma si: Android, iOS dhe zhvillim të webit.

Scooler është kompani që mundohet të ndihmojë të rinjtë në sektorin e edukimit me qasje në teknologji. Misioni i tyre është të ndihmojë komunikimin dhe qasjen në informacion në mes të profesorëve dhe studentëve në mënyrë që të përgatiten për tregun e punës.

SevenSigns është startup që fokusohet në krijimin e aplikacioneve që lehtësojnë jetën e njerzve. Produkti i parë i tyre quhet Sumthesun – një platformë që ndihmon pronarët e shtëpive të vendosin për instalimin e paneleve solare duke i udhëzuar ata gjatë procesit.

Happy Feet është një aplikacion i cili lidhë inteligjencën artificiale me computer vision, ku i'u mundëson njerzve ti provojnë keputet që dëshirojnë ti blejnë përmes telefonave të mençur. Mjafton të skenohet këmba dhe pastaj të bleni këpucë nga shitësit e duhur.

Skins i'u mundëson startup-ëve të përfshihen në shërbime ku mund të gjejnë fonde për idetë e tyre.

VIP Lounge

Pjesë e KosICT 2017 ishte edhe salla e biznesit – një vend i veçantë në Pallatin e Rinisë dhe Sportit, ku vetëm folësit, investitorët, ndërmarrësit dhe perfaqësuesit e kompanive ishin të lejuar të hynin.



Si hapësirë lidhëse, salla e biznesit u siguroi të gjithëve mundësi të ndiheshin rahat e të flisnin me njëri-tjetrin me qëllim që të ndanin ide potenciale për biznes, e të krijonin partneritete të reja. Kjo sallë ishte dekoruar në menyrë të jashtëzakonshme nga mbështetësit tanë “Light House”, të cilët na pajisën me karrige dhe tavolina luksoze për të gjithë. Gjithashtu, folësit, investitorët dhe ndërmarrësit patën mundësinë të shijojnë shërbimet e furnizimit ushqimor të ofruara nga Meridian Cooperation.



KosICT Nights

Për ta bërë Festivalin e Teknologjisë KosICT'17 akoma më tërheqës dhe përmbushës, ekipi kishte organizuar mbrëmje të shkëlqyera, ku pjesëmarrësit dhe gjithë të tjerët patën mundësinë të takonin folësit dhe të diskutonin rreth temave të KosICT-së.



U mbajt edhe edicioni FuckUp Nights i KosICT-së si pjesë e konferencës, ku disa nga folësit tanë ndanë historitë dhe dështimet e tyre dhe si ia dolën të ktheheshin sërish në këmbë. Këtë vit në edicionin Fuckup Nights të KosICT-së kemi pasur tre folës të cilët kanë ndarë me ne eksperiencat e tyre. I pari ishte z. Martin Baros nga Cryptelo, i cili ndau me ne dështimin e krijimit të kompanisë së tij. Folësi i dytë i cili tregoi rreth dështimeve të tij ishte partner në Blockchain Technologies Cooperation, z. Peter Gerald Mikkelsen dhe folësi i tretë ishte z. Mikko Alassarela-krijuesi i Inbot. Pas fjalimeve të folësve, audienca u drejtoi pyetje folësve, e kështu sesionet folëse u bënë shumë atraktive ku gjithësecili mund të merrte pjesë e të shprehte mendim. I gjithë eventi u mbajt në një klub vendor të quajtur Bonzai.

Pas përfundimit të FuckUp Nights, erdhi koha për festë. Në po të njejtin klub, duke filluar prej 23:00 mori vend festa e KosICT'17, ku DJ vendorë emocionuan turmën dhe pjesëmarrësit e konferencës me muzikën e tyre.

Në natën e dytë, perfaqësuesit e KosICT-së organizuan darkën për folësit dhe partnerët në një restaurant vendor të quajtur "Gagi Restaurant". Ishte një atmosferë e shkëlqyer për një festë lamtumirëse, ku folësit shijuan muzikën tradicionale, ushqimin dhe pijet. Folësit dhe partnerët patën mundësinë të falenderonin njëri-tjetrin për praninë e tyre në konferencën e këtij viti, duke e lënë bisedën të hapur për vitet e ardhshme.



Statistika

KosICT tregoi një angazhim të madh në rrjetet sociale, ku arriti të zgjojë interesimin e 80,000 njerëzve. Duke u pasur parasyshë se folësit e KosICT 2017 ishin pjesë e kompanive më të mëdha në botë dhe se udhëtuan nga kontinente të ndryshme, harta tregoi se KosICT u përmend në vende të ndryshme të botës përmes statuseve dhe fotografive në rrjetet sociale, duke përdorur fjalët kyçe, temat, folësit dhe duke përmendur përshtypjet pozitive.

Postimet nuk vinin vetëm nga kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të konferencës, por edhe nga persona të tjerë dhe organizata që ishin pjesë e konferencës. Hashtag zyrtar i ngjarjes ishte #KosICT17.


Your Tweets earned **8.1K impressions** over this 7 day period



Post Reach

The number of people your posts were served to.

Organic Paid



Sponsorët & Partnerët

Supported by:



VIP Sponsor:



Gold Sponsors:



Topic Sponsors:



Supporting Sponsors:



Creative Partners:



Media Partners:



Other Partners:



STIKK Gold Members:



Ju falenderojmë për përkrahjen tuaj dhe shihemi në KosICT18!

Vjollca Çavolli

Me respekt,

Vjollca Çavolli
Drejtoreshë Ekzekutive,
STIKK



KOSICT
www.kosict.com

SUPPORTED BY:



Ministria e Ekonomisë dhe
Financës



german
cooperation

giz

Experte Dienstleistungen
für nachhaltige
Entwicklungsprojekte



USAID
U.S. AGENCY FOR
INTERNATIONAL DEVELOPMENT



SWEDEN



Organizuar nga:



STIKK

Në bashkëpunim me:



UNIVERSUM
COLLEGE